

**“CREDINS INVEST” SH.A.
SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE**

PASQYRAT FINANCIARE

31 Mars 2024

Raportet financiare për 3 mujorin e parë, 2024

TABELA E PERMBAJTJES

1 Pasqyrat financiare të Shoqërisë

1. Pasqyra e Bilancit
2. Pasqyra e Fitim / Humbjeve
3. Pasqyra e Fluksit të Parave
4. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit
5. Shënime

Pasqyrat financiare të Shoqërisë

Informacioni	Përshkrimi, vlera
Kodi i shoqërisë administruese	K52311009R
Numri i regjistrimit në QKR	CN-741398-06-16
Numri për raportimin	3
Adresa	Njesia bashkiake Nr. 5, Rr. "Nikolla Tupe", Nr. 1, Kati 3, Tiranë
Telefon dhe fax	+355 69 60 60 058;
Email:	acitozi@credinsinvest.net
Faqe ëeb	www.credinsinvest.com
Data e licensimit	30 Maj 2016
Data e miratimit të Fondit te Pensionit	13 Dhjetor 2011
Data e miratimit të Fondit të Investimit	30 Maj 2016
Emri dhe mbiemri i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ	Vjosa Bodo - Kryetare Eugen Nuri-anëtar Estela Koçi-anëtare Armira Citozi-anëtar Egi Santo-anëtar
Pesë aksionerët më të mëdhenj (emri,mbiemri, adresa, ose emri i shoqërisë dhe adresa e zyrtare, përqindja e aksioneve në pronësi)	
Emri i shoqërisë	CREDINS BANK
Adresa zyrtare	Rr.Vaso Pasha, Nr.8, Tiranë
Përqindja e aksioneve	76%
Emri i shoqërisë	SiCRED Shoqëri Sigurimi Jete
Adresa zyrtare	Nj.bashk. 5, Rr. Brigada 8, Vila 3/1
Përqindja e aksioneve	12%
Emri aksionerit	Estela Koçi
Përqindja e aksioneve	5%
Emri aksionerit	Egi Santo
Përqindja e aksioneve	3.5%
Emri aksionerit	Genc Koxhaj
Përqindja e aksioneve	3.5%
Shoqëria audituese	RSM Albania shpk Albanian Audit Partners shpk
Numrat e llogarisë :	
Nr. e llogarisë të Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Siper marrjeve te Investimeve Kolektive	
Banka Credins në lekë	318654
Banka Credins në euro	318656
Tirana Bank	0111-313969-100;
ABI Bank	AL07 2101 1012 0000 0000 0166 7186
Nr e llogarisë të Fondit Vullnetar "Credins Pension":	
Tirana Bank	0110-313-979-100;0111-313979-100; 0111-313979-101
Nr e llogarisë të Fondit te Investimeve "CREDINS PREMIUM":	
ABI Bank	AL98 2101 1012 0000 0000 0166 7197

1. Pasqyra e Bilancit

AKTIVI		31/03/2024	31/12/2023
A. Aktive afatgjata (I+II+III+IV)		70,434,658	69,233,457
I. Aktive afatgjata materiale (1+2)		17,601,590	15,598,038
1. Ndërtesa- Aktive me te drejte perdorimi	4	9,864,205	7,974,541
2. Të tjera aktive afatgjata materiale	5	7,737,385	7,623,497
II. Aktive jo-materiale	6	1,432,304	1,527,791
III. Aktive financiare(1+2+3+4)		51,400,764	52,107,628
1. Depozita bankare			
2. Të vlefshme për shitje		-	-
3. Të mbajtura deri në maturim	7	51,400,764	52,107,628
4. Të tjera aktive financiare afatgjata			
IV. Investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto			
B. Aktivi tatimor i shtyrë			
C. Aktive afatshkurtra (I+II+III+IV+V+VI+VII)		54,861,634	51,026,902
I. Pajisje në magazinë, inventar i imët dhe pajisje të tjera			
II. Llogari të arkëtueshme tregtare (1+2+3+4)		8,668,785	6,460,300
1. Llogari të arkëtueshme nga fondet e pensioneve dhe investimeve	8	8,505,951	6,460,300
2. Llogari të arkëtueshme nga shumat e paguara tepër, bazuar në fitim.			
3. Llogari të arkëtueshme nga shteti dhe institucione të tjera			
4. Të tjera llogari të arkëtueshme nga staf		162,834	-
III. Aktive financiare (1+2)		40,328,630	39,971,505
1. Depozita bankare			
2. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të vlefshme për shitje			
3. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të mbajtura deri në maturim			
4. Kuota ne fonde investimi	9	40,328,630	39,971,505
IV. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (1+2)		5,608,173	3,924,827
1. Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë	10	5,608,173	3,924,827
2. Mjete monetare në arkë			
V. Shpenzime të periudhave të ardhme dhe parapagime		-	396,583
VI. Parapagime detyrime tatimore	11	256,046	273,687
D.Totali i Aktiveve(A+B+C)		125,296,292	120,260,359

PASIVI	Shënime		
		31/03/2024	31/12/2023
A. Kapitali (I+II+III+IV+V+VI)	12	109,698,095	106,159,470
I. Kapitali i nënshkruar		95,822,394	95,822,394
II. Rezerva të kapitalit	12	10,000,000	10,000,000
III. Rezerva e rivlersimit			
IV. Rezerva të tjera			
V. Fitime / humbje të mbartura	12	337,076	-12,998,127
VI. Fitimi /humbja neto për periudhën		3,538,625	13,335,203
B. Detyrime afatgjata (I+II+III)			
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit			
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi			
III. Detyrime të tjera afatgjata			
C. Detyrim tatimor i shtyrë			
D. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe			
E. Detyrime afatshkurtra (I+II+III+IV+V)		15,598,197	14,100,889
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit			
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi	13	9,281,549	7,048,207
III. Llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme	14	6,316,648	7,052,682
IV. Shpenzime të shtyra			
V. Të ardhura të marra në avancë			
F. Totali i pasivit (A+B+C+D+E)		125,296,292	120,260,359

2. Pasqyra e Fitim / Humbjeve

		31/03/2024	31/03/2023
I.Të ardhura nga administrimi i fondit (1+2+3)		17,082,876	15,732,787
1.a Tarifa të administrimit të Fondit të Pensionit Vullnetar Credins Pension	15	10,457,013	8,494,587
1.b Tarifa të administrimit të Fondeve të Investimit	15	5,933,011	6,089,364
2.Tarifa të largimit nga Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension	16	692,852	1,148,003
3.Tarifa të tjera		-	833
II. Shpenzime nga administrimi i fondit (1+2+3+4)		1,009,673	890,627
1.a Shpenzime të transaksioneve dhe tarife depozitari për Fondin e Pensionit		715,430	613,811
1.b Shpenzime të transaksioneve dhe tarife depozitari për Fondin Investimit			-
2. Shpenzime të marketingut			
3. a Shpenzime të shitjes me agjent FI		443	26,632
4. Shpenzime të tjera të administrimit të fondit të pensionit		293,800	250,184
III. Fitim / Humbja nga administrimi i fondit të pensionit (+/-) (I - II)		16,073,203	14,842,160
IV. Të ardhura të tjera			
V. Shpenzime të veprimtarisë së shoqërisë administruese (1+2+3+4+5+6)		12,583,789	12,635,725
1. Shpenzime për materiale			
2. Shpenzime për personelin	17	8,570,227	8,233,423
3. Amortizim i aktiveve materiale/jomateriale afatgjata	4,5,6	1,300,740	1,536,432
4. Rregullim i vlerës së aktiveve afashkurtra			
5. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe			
6. Shpenzime të tjera të veprimtarisë	18	2,712,822	2,865,870
VI. Të ardhura financiare	19	890,561	805,502
VII. Shpenzime financiare		216,887	42,061
VIII. Fitim / Humbja para tatimit (III+IV-V+VI-VII)		4,163,088	2,969,876
IX. Tatimi mbi fitimin		624,463	445,480

3.Pasqyra e flukseve të parasë

	31/03/2024	31/12/2023
a. Arkëtime nga veprimtaria shfrytëzuese	16,582,337	119,294,367
b. Pagesa për veprimtarinë shfrytëzuese	14,505,598	133,863,724
c. Flukse monetare neto nga veprimtaria shfrytëzuese (a - b)	2,076,739	-14,569,357
d. Arkëtime nga veprimtaria investuese		
e. Pagesa për veprimtarinë investuese	393,393	303,783
f. Flukse monetare neto nga veprimtaria investuese (d - e)	-393,393	-303,783
g. Arkëtime nga veprimtaria financuese		
h. Pagesa për veprimtarinë financuese		2,681,010
i. Fluksi monetar neto nga veprimtaria financuese (g - h)	-	-2,681,010
j. Rritja/rënia neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare(c+f+i)	1,683,346	-17,554,150
k. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të periudhës kontabël	3,924,827	21,478,977
l. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhës kontabël (j+k)	5,608,173	3,924,827

4. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

	Lek	Lek	Lek	Lek
	31/12/2023	Rritje	Zbritje	31/03/2024
I.Kapitali i nënshkruar	95,822,394			95,822,394
II. Rezerva kapitali	10,000,000			10,000,000
III. Rezerva e rivlerësimit				
IV. Rezerva të tjera				
V. Fitime (Humbje) të mbartura	337,076			337,076
VI. Fitimi (Humbja) e periudhës financiare		3,538,625		3,538,625
VII. Pagesat e dividendit				
VIII. Ndryshimet në politikat kontabël dhe korigjime (1+2+3+4+5+6)				
TOTALI I KAPITALIT	106,159,470	3,538,625		109,698,095

1. Informacione të përgjithshme

“CREDINS INVEST” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve (në vijim “Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptare me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 34260, më datë 31 Tetor 2005 dhe me seli në Rrugën “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë.

Shoqëria fillimisht u liçencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më datë 23 nëntor 2011, me licencën nr. 3, për të vepruar si Shoqëri Administruese e fondeve të pensionit vullnetar, në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit sipas Ligji Nr.10197, datë 12 dhjetor 2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Më 30.05.2016, Shoqëria u pajis me liçencën nr. 3, për të administruar asetet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", krahas veprimtarisë për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar. Emri i Shoqërisë u ndryshua në “CREDINS INVEST” sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Vullnetar dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Shoqëria ka në administrim një fond pensioni vullnetar, me emrin “Credins Pension” miratuar më 13 dhjetor 2011 me vendimin Nr. 173 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare; dhe një fond investimi me emrin “Credins Premium”, miratuar më 30 maj 2016 me vendimin Nr. 85 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Fondi i Investimit ka filluar veprimtarinë e tij më 1 korrik 2016.

Banka Depozitare e Fondit të Pensionit është Banka e Tiranës sh.a., miratuar me Vendimin Nr.91, datë 18 Korrik 2012, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Banka Depozitare e Fondit “Credins Premium” është Banka Amerikane e Investimeve sh.a., miratuar me Vendimin Nr.2, datë 31 Janar 2018, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Pas ndryshimeve në Ligjin nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” shoqëria ka përshtatur aktivitetin e saj me ndryshimet legjislative.

Shoqëria Administruese e Fondeve “Credins Invest” Sh.a., pas licenses lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr.206 datë 29/12/2020 për miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë dhe Vendimin nr.207 datë 29/12/2020 për licensimin e shoqërisë “Credins Invest” për ofrimin e Fondeve të Investimit Alternative vetëm për klientët profesionistë dhe të kualifikuar dhe në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, ushtron veprimtarinë e administrimit të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me ofertë publike, administrimin e fondeve të investimeve alternative vetëm për klientët profesionistë dhe të kualifikuar dhe administrimin e fondeve të pensionit vullnetar .

Më 26 Mars 2021, Bordi Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar regjistrimin e Fondit të Investimeve Alternative për klientët profesionistë dhe të kualifikuar . Fondi investimit alternativ “Sea Land Alternative Investment Fund”- Shoqëri Komandite SIK, do të administrohet nga shoqëria administruese në përputhje në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”. Banka Depozitare e Fondit është Banka Amerikane e Investimeve sh.a..

Me Vendimin nr. 241, date 29.12.2021 Bordi Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar regjistrimin e Fondit të Investimeve Alternative për klientët profesionistë dhe të kualifikuar Green Vieë Alternative Investment Fund - Shoqëri Komandite SIK me NIPT M12227046E, themeluar datë 21.10.2021 dhe regjistruar në QKB më 27.10.2021. Banka Depozitare e Fondit është Banka Amerikane e Investimeve sh.a..

Miratimi në datë 21.09.2023, i ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, i cili ka hyrë në fuqi në datë 06.11.2023, si dhe hartimi/miratimi nga AMF i akteve nënligjore kërkon që Shoqëria Administruese të kryejë procesin e përshtatshmërisë së aktivitetit të shoqërisë dhe të fondit sipas kërkesave ligjore brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike përveç aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të cilat janë paraqitur me vlerë të drejtë

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lekë”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të çmuara. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerë me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lek kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Mars 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 ishin si më poshtë:

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
EUR	102.87	103.88

b) Plani i Kontributeve të Përcaktuara

Nën planin e kontributeve të përcaktuara, shuma e përfitimeve të ardhshme është përcaktuar nga kontributet e paguara dhe nga interesat e fituara të fondit. Detyrimet janë njohur në fitim apo humbje në periudhën e duhur dhe janë paraqitur interesa të shtuara te fondit të pensionit nga të ardhurat nga investimet.

c) Instrumentat Financiare

Njohja dhe çregjistrimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivitetet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shlyhet, anulohet ose skadon.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Instrumentat Financiare (vazhdim)

Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitetit financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

Aktivet financiare me kosto të amortizuar

Aktivet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, shumica e të arkëtueshmeve të tjera, si dhe obligacioneve të listuara që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39 bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Aktivet financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli i biznesit, aktivet financiare, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit kalsifikohen në kategorinë FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të paracaktuara si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës (shih më poshtë).

Kjo kategori gjithashtu përmban një investimet në kapital. Aktivet në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Sipas kërkesave të SNRF 9 nuk lejohet mbajtja me kosto e këtyre aktiveve.

Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Shoqëria llogarit aktivet financiare me me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse FVOCI nëse aktivet plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektivi i të cilit është "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" dhe
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çrregjistrimit të aktivit.

Aktivet financiare të klasifikuara si të vlefshme për shitje (AFS) sipas SNK 39 (periudhat krahasuese)

Aktivet financiare të vlefshme për shitje AFS janë aktive financiare jo-derivative të cilat janë të përcaktuara në këtë kategori ose nuk kualifikohen për përfshirje në ndonjë nga kategoritë e tjera të aktiveve financiare (FVTPL ose të mbajtura deri në maturim dhe kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme).

Të gjitha aktivet financiare të vlefshme për shitje AFS maten me vlerën e drejtë. Fitimet dhe humbjet njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse brenda kapitalit neto, përveç të ardhurave nga interesi dhe dividendët, humbjet nga zhvlerësimi dhe diferencat në valutë të huaj mbi aktivet monetare, të cilat njihen në fitim ose humbje. Kur aktivi është shitur ose zhvlerësuar, fitimi ose humbja kumulative e njohur në kapitalin neto është riklasifikuar nga rezerva e kapitalit neto në fitim ose humbje. Interesi është llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe dividendët janë njohur në fitim ose humbje brenda të ardhurave financiare.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'.

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare për periudhën 2024.

i) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Shoqërisë nuk janë ndikuar nga adoptimi i SNRF 9.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Grupi ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

d) Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjete monetare në arkë dhe bankë përfshin gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes.

e) Depozita me afat

Depozitat me afat janë vendosur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe janë klasifikuar si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi është përlllogaritur në baza përlllogaritje dhe interesi i arkëtueshëm është pasqyruar në të arkëtueshme të tjera.

f) Aktive afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e programeve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje. Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë (komponentet kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

ii) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

iii) Zhvlerësimi

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me metodën e vlerës së mbetur. Aktivitet me qira zhvlerësohen për më të voglën mes periudhës së qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme.

Norma e amortizimit vjetor është si me poshtë:

Pajisje zyre	20 %
Pajisje informatike	25 %

g) Aktive te patrupezuara

Aktivet e patrupëzuara njihen me kosto historike, zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, bazuar në metodën e vlerës së mbetur. Norma e amortizimit vjetor është 25%.

h) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aktivi, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është zbutur, ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke zbritur zhvlerësimin apo amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

Kapitali aksioner

Kapitali aksionar paraqitet në vlerën e tij nominale. Kapitali aksionar i cili është i nënshkruar për emetim, por që ende nuk është i regjistruar është i paraqitur veçmas në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit. Një kontribut i pafinancuar i kapitalit, i cili është i pagueshëm në të ardhmen në një shumë të parapërcaktuar, është klasifikuar si kapital i paregjistruar dhe i papaguar, përveç rasteve kur marrja e kontributit është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme.

k) Të ardhurat nga penalitetet

Shoqëria njihet të ardhura nga penaliteti në rast tërheqje të parakohëshme nga anëtarët i aseteve nga llogaria individuale në fondin e pensionit vullnetar, sipas kërkesave të rregullores nr. 125, datë 07.12.2010 "Për penalitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohëshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar". Penaliteti llogaritet mbi vlerën neto të aseteve të kërkuara për t'u tërhequr para kohe, pasi është zbritur tatimi sipas legjislacionit në fuqi në momentin e tërheqjes. Shoqëria nuk njihet të ardhura nga penaliteti në rast tërheqje të parakohëshme nga anëtarët i aseteve nga llogaria individuale në fondin e investimit.

l) Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan kontribute shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

(ii) Kontributet shoqërore vullnetare

Shoqëria paguan kontribute shoqërore vullnetare për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin.

m)Tatimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave të tjera. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi, ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme sipas ligjit shqiptar të tatimit.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ky aktiv mund të përdoret. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë impaktin e pozicioneve

tatimore të pasigurta dhe tatimet dhe interesat shtesë. Shoqëria beson se përlllogaritjet për detyrimet tatimore janë të mjaftueshme për të gjithë vitet e hapura tatimore në bazë të vlerësimit të shumë faktorëve duke përfshirë interpretimet tatimore dhe eksperiencat e mëparshme.

4. Aktive me të drejtë përdorimi

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Gjendja më 1 janar	7,974,541	4,556,170
Shtesa nga rinjohja	2,786,410	7,405,643
Total	10,760,951	11,961,813
Shpenzime amortizimi	896,749	3,987,272
Gjendja ne fund	9,864,202	7,974,541

Shoqëria ka lidhur kontratë qiraje më datë 07 janar 2019 për ambjentet e zyrave dhe ka rinjohur aktivin me të drejtë përdorimi, duke u bazuar në gjykimet e arsyeshme ka rinjohur detyrimin për qera financiare dhe amortizimin e aktivit për periudhën 2024-2026.

5. Aktive afatgjata materiale, neto

	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Totali
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	4,409,398	12,707,297	17,116,695
Shtesa		422,392	422,392
Pakësime			-
Gjendja më 31 Mars 2024	4,409,398	13,129,689	17,539,087
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	3,014,227	6,478,971	9,493,198
Shpenzimi për periudhen	69,759	238,745	308,504
Pakësime			
Gjendja më 31 Mars 2024	3,083,986	6,717,716	9,801,702
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	1,395,171	6,228,326	7,623,497
Gjendja më 31 Mars 2024	1,325,412	6,411,973	7,737,385

6. Aktive afatgjata jomateriale, neto

	Sisteme elektronike	Totali
<i>Kosto</i>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	10,762,402	10,762,402
Shtesa		-
Pakësime		
Gjendja më 31 Mars 2024	10,762,402	10,762,402
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	9,234,611	9,234,611
Shpenzimi për periudhen	95,487	95,487
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Mars 2024	9,330,098	9,330,098
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	1,527,791	1,527,791
Gjendja më 31 Mars 2024	1,432,304	1,432,304

7. Aktive financiare të mbajtura në maturim

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Obligacione (vlera nominale)	51,000,000	51,000,000
Premium/discount	- 52,983	- 47,944
Interes i përlogaritur	453,747	1,155,572
Totali	51,400,764	52,107,628

Shoqëria nuk ka patur investime të reja në letra me vlerë për 2024.

8. Llogari të arkëtueshme nga fondet e pensione dhe investimeve

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Të arkëtueshme nga tarifë administrimi Fondi Pensionit Credins Pension	3,619,465	3,455,745
Të arkëtueshme nga tarifë administrimi Fondi Investimit Credins Premium	527,865	529,611
Të arkëtueshme nga tarifë administrimi “Green Vieë Alternative Investment Fund”- Shoqëri Komandite SIK	1,696,987	933,998
Të arkëtueshme nga tarifë administrimi “Sea Land Alternative Investment Fund”- Shoqëri Komandite SIK	2,661,634	1,540,946
Totali	8,505,951	6,460,300

9. Kuota në Fond Investimi

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Gjendje Fondi Investimit Credins Premium	40,328,630	39,971,505
Totali	40,328,630	39,971,505

Më 29 Dhjetor 2023 Shoqëria bleu 23,117.3838 kuota me cmim 1,297.7247 lekë/kuotë dhe vlerë nominale 30,000,000 lekë. Më 31 Dhjetor 2023 çmimi i kuotës rezultoi 1,297.9038 lekë/kuotë.

Gjatë 2024 nuk ka blerje kuota dhe më 31.03.2024 çmimi i kuotës rezultoi 1.309,4999 lekë/kuotë, gjendja e kuotave 30.796,9706.

10. Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Llogari në banken Credins në Lek	4,542,652	3,211,885
Llogari në banken Tirana në Lek	220,787	116,807
Llogari në banken ABI në Lek	766,245	217,654
Llogari në Credins Bank në Euro	78,489	378,481
Totali	5,608,173	3,924,827

11. Parapagime detyrime tatimore

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Parapagim tatim fitimi	256,046	273,687
Totali	256,046	273,687

12. Kapitali

Më 31 Mars 2024, kapitali aksionar i regjistruar është 95,822,394 Lekë, dhe përbëhet nga 233,713.17 aksione me vlerë nominale Lek 410 (2022: Kapitali aksionar 95,822,394 Lekë) .

	31 Mars 2024			31 Dhjetor 2023		
	Në %	Numër aksionesh	Në Lek	Në %	Numër aksionesh	Në Lek
CREDINS Bank	76%	177,622.00	72,825,019	76%	177,622.00	72,825,019
SiCRED Sh.a.	12%	28,045.58	11,498,687	12%	28,045.58	11,498,687
Estela Koçi	5%	11,685.66	4,791,120	5%	11,685.66	4,791,120
Genc Koxhaj	3,5%	8,179.96	3,353,784	3,5%	8,179.96	3,353,784
Egi Santo	3,5%	8,179.96	3,353,784	3,5%	8,179.96	3,353,784
	100	233,713.16	95,822,394	100	233,713.16	95,822,394

13.Detyrime të qirasë financiare

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Gjendja më 1 janar	7,048,208	4,060,775
Shpenzimi i interesit	169,401	558,794
Humbje/fitim nga kursi i këmbimit	-89,193	-859,928
Lease payments for the year	-936,331	-3,927,091
Njohje detyrimi	3,089,464	7,215,658
Gjendja ne fund	9,281,549	7,048,208

14.Detyrime llogari të pagueshme

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Furnitorë	5,319,659	4,988,202
Detyrime për taksa TVSH dhe sigurime shoqërore , personeli	894,597	1,319,687
Shërbime profesionale të përlllogaritura	90,672	466,712
Detyrim ndaj AMF	-	256,361
Shpenzime të tjera të përlllogaritura	11,720	21,720
Shpenzime te perlllogaritura per banken depozitare FP	-	-
Shpenzime te perlllogaritura tarifa	-	-
Total	6,316,648	7,052,682

15 . Tarifa të administrimit

Shoqëria mban një tarifë administrimi prej 2% në vit të Vlerës Neto të Aseteve të Fondit të Pensionit; 1% në vit të Vlerës Neto të Aseteve të Fondit të Investimit, si dhe një tarifë administrimi prej 0.35% të vlerës së aktiveve të secilit fond investimi alternativ.

	31 Mars 2024	31 Mars 2023
Të ardhura nga tarifa administrimit, Fondi Pensionit	10,457,013	8,494,587
Të ardhura nga tarifa administrimit, Fondi Investimit Alternativ “Green Vieë Alternative Investment Fund”	1,696,987	1,605,658
Të ardhura nga tarifa administrimit, Fondi Investimit Alternativ “Sea Land Alternative Investment Fund”	2,661,633	2,496,496
Të ardhura nga tarifa administrimit, Fondi Investimit Credins Premium	1,574,391	1,987,210
Total	16,390,024	14,583,951

16.Tarifa të largimit nga fondi

Shoqëria mban penalitet ndaj anëtarëve të fondit të pensionit nëse tërhiqen para kohe.

	31 Mars 2024	31 Mars 2023
Tarifa të largimit nga Fondi I Pensionit Vullnetar Credins Pension	692,852	1,148,003
Total	692,852	1,148,003

17.Shpenzime personeli

	31 Mars 2024	31 Mars 2023
Paga dhe shpërblime	7,136,146	6,845,095
Sigurime Shoqërore	969,186	869,287
Pension Vullnetar	180,750	183,000
Sigurim jete shëndeti	284,145	336,041
Total	8,570,227	8,233,423

18. Shpenzime të tjera të veprimtarisë

	31 Mars 2024	31 Mars 2023
Shërbime mirembajtje sisteme	680,658	856,307
Shpenzime marketingu dhe design	348,970	220,403
Asistance nga palë të treta	287,343	501,763
Tarifë për AMF FP	262,378	231,005
Printime	244,400	58,200
Tarife Bordi	190,000	380,000
Taksa vendore dhe tarifa regjistrimi dhe noteriale	189,660	20,000
Energji	160,494	97,062
Shpenzime kuota dhe trajnime profesionale	99,440	88,282
Shpenzime postare dhe telefonike	96,859	110,326
Shpenzime të tjera	75,482	228,530
Komisione bankare	40,438	9,042
Kancelari	36,700	44,100
Shpenzime pritje	0	20,850
Total	2,712,822	2,865,870

19. Të ardhurat financiare

	31 Mars 2024	31 Mars 2023
Depozita dhe llogari rrjedhese	1,012	
Fitim humbje nga kuotat në Fondin e Investimit	357,125	
Letra me vlere	701,825	828,972
Interesa qera financiare	169,401	-23,470
Total	890,561	805,502

20. Ngjarje pas dates së raportimit

Nuk ka ngjarje pas datës së bilancit që mund të kërkojë korigjim ose shënime shtesë në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Përgatiti

Armira CITOZI
Drejtoresh e Financës dhe Kontabilitetit

Miratoi

Estela KOCI
Administratore e Përgjithshme